

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Namik Hyseni

Dhe

Alket Hyseni

Tirane më, 25.10.2022

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

E lidhur në Tiranë, sot më 25 / 10 / 2022, nga dhe ndërmjet:

Shitësi:

Namik Hyseni, i biri i Myslymit, i datëlindjes 05/08/1941, lindur ne Tepelenë dhe banues ne Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035309316 dhe numër personal E10805220L, madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar,

(se bashku ne vijim "**Shitësi**")

dhe

Blerësi:

Alket Hyseni, i biri i Namikut, i datëlindjes 12/05/1974, lindur ne Levan, Tepelene dhe banues ne Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035306158 dhe numër personal H40512162M, madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar;

(ne vijim "**Blerësi**")

MEQENËSE:


- A. Shitesi Namik Hyseni eshte ortaku i vetem zotërues i 100% te kapitalit te shoqerise tregtare me përgjegjësi te kufizuar "H&A Law Firm" shpk, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L32319015I, me seli ne adresën: Tirane, Rruga e Barrikadave, Godina "Turdiu Center", Kati 6, Ap.4 (me poshtë referuar "**Shoqëria**"), vlere e kapitalit te se ciles eshte 100.000 (njëqind mije) lekë.
- B. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit dhe ky i fundit dëshiron te blejë nga Shitësi gjithsej 51% (pesedhete e nje perqind) te kapitalit te Shoqërisë;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur te Ortakut te Vetem te Shoqërisë, Palët dëshirojnë te lidhin këtë Kontrate.

NË BAZË TË SA MË SIPËR, PALËT RANË DAKORD SI VIJON:

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi i transferon dhe kalon ne pronësinë e vetme ligjore te Blerësit një kuote qe përfaqëson 51% (pesedhete e nje perqind) te kapitalit te Shoqërisë dhe Blerësi blen kuotën e mesiperme, kundrejt çmimit te shitjes dhe sipas kushteve e afateve te përcaktuara këtu.
2. Çmimi i shitjes se kuotës se kapitalit është LEK 51.000 (pesedhete e njëmijë leke) dhe Palët vërtetojnë se pagesa e çmimit te mësipërm te shitjes është kryer tërësisht nga Blerësi ne favor te Shitësit me lidhjen e kësaj Kontrate dhe kjo Kontrate shërben edhe si një dëftesë për vërtetimin e pagimit te shumes. Palët e vërtetojnë shlyerjen e çmimit dhe nuk kane asnjë pretendim tjetër te asnjë lloji.
3. Me lidhjen e kësaj Kontrate Blerësi behet ortak zotërues i 1 (një) kuote qe përfaqëson 51% te kapitalit te Shoqërisë, ndërsa Shitësi mbetet ortak zotërues i 1 (një) kuote qe përfaqëson 49% te kapitalit te Shoqërisë.

1

Adresa: Rruga e Barrikadave, Turdiu Center, Kati 6, Apartamenti 6, Tirane, Nr. Cel. 0685748066,
E-mail: ha-lawfirm@ha-lawfirm.al



2022

4. Blerësit i lind e drejta e regjistrimit te pronësisë së vet mbi kuotën në librin e ortakeve dhe në regjistrin tregtar (QKB) sipas ligjit.
5. Shitësi deklaron dhe garanton se pjesët e kapitalit të transferuara nëpërmjet kësaj Kontrate, janë në pronësinë e vetme e të plotë ligjore të Shitësit dhe janë të lira nga barra, të drejta të tjera reale apo pengje apo të drejta të çfarëdolloji të palëve të treta mbi to.
6. Blerësi deklaron dhe garanton se e njeh gjendjen e Shoqërisë dhe se ka verifikuar regjistrimet e saj kontabël si dhe të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë në tërësi dhe për këtë nuk ka dhe shprehimisht heq dorë nga çdo rezervë, pretendim apo padi kundër Shitësit, duke garantuar se do ta mbajë Shitësin të padëmtuar nga çfarëdo pretendimi i tille.
7. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te kuotave objekt të kësaj Kontrate ne librin e ortakeve si dhe ne regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas kërkesave te ligjit.

Kontrata miratohet në tërësi edhe nga bashkeshortja e shitësit, Znj. Hanks Hyseni, shtetase shqiptare, e bija e Sadikut dhe e Anifes, lindur me 20.4.1941 ne Tepelenë dhe banuese në Tiranë, me adrese: Rr. Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 13, Apartamenti nr. 106, Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 035236719 dhe nr. personal E15420040R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për te vepruar.

Kjo Kontrate u hartua në 4 (katër) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe dhe ne dy fletë, dhe pasi u lexua prej palëve, u gjet e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, u nënshkrua rregullisht nga palët si vijon:

SHITËSI

Namik Hyseni

Namir Hyseni
[Signature]



BLERËSI

Alket Hyseni

Alket Hyseni
[Signature]
2022

MIRATOI

Hanks Hyseni

Hanks Hyseni
[Signature]